

1. Titulli i projektit:	Përforcimi i Rrjetit të Tensionit të Ulët 2014 – Dislokimi i njehsorëve Distrikti i Gjakovës
2. Përshkrimi i projektit:	<p>Fushëveprimi i këtij projekti përfshin furnizimin me material, instalimin, testimin dhe komisionimin kryesisht të rrjetit të tensionit të ulët 0.4 kV të shpërndarjes në regjionet e Distriktit të Gjakovës. Projekti përfshin ndërtimin dhe komisionimin e :</p> <ul style="list-style-type: none">• Linjave ajrore 10(20) kV;• Rrjetin e tensionit të ulët 0,4 kV;• Vendosjen e ormanëve jashtë oborreve të konsumatorëve dhe zhvendosjen e njehsorëve (pikës matëse) <p>Arsyetimi: Rrjeti i vjetruar i distribuimit të energjisë i trashëguar nga KEDS nuk garanton cilësi dhe siguri të furnizimit me energji. Si rrjedhojë e rrjetit të vjetruar dhe rritjes së numrit të konsumatorëve të amvisërisë (rezidencial) dhe atyre komercial dhe rrjedhimisht rritjes së konsumit të energjisë, kapacitetet aktuale nuk i plotësojnë kriteret teknike dhe si pasojë cilësia e furnizimit deri tek konsumatori i fundit nuk është në cilësi të kënaqshme dhe në kufijtë e kërkuar teknik.</p> <p>Për më tepër, rreth 1080 konsumatorët do të ndikohen drejtpërdrejt nga 11 projekte që janë duke u implementuar bashkë me këtë projekt. Konsumatorët që do të përfitojnë nga këto projekte</p>

	<p>janë furnizuar përmes linjava të gjata dhe të vjetruara 0,4 kV dhe aktualisht janë duke u përballur me rënie të tensionit sidomos gjatë orëve të pikut (shfrytëzimit maksimal) të energjisë elektrike.</p> <p>Objektivat e projektit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i kualitetit dhe rritja e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike; • Përkrahja e rritjes së ngarkesës; • Eliminimi i fyteve të ngushta; • Reduktimi i humbjeve teknike; • Reduktimi i rënieve të tensionit; • Reduktimi i orëve të humbura për konsumator (SAIDI, SAIFI). etj.
3. Data e fillimit:	16 prill 2014
4. Data e përfundimit:	31 dhjetor 2014
5. Kostoja e projektit	0,7 milion €
6. Sponsor i projektit:	KEDS, Divizioni i Rrjetit
7. Njësia Sponsor:	Departamenti për Kontrollin e Investimeve

Nr.	Përshkrimi i projektit	Data e fillimit	Data e përfundimit
1	Ts 10/0,4 kV Osek Pashë 2	20.06.2014	31.12.2014
2	TS 10/0,4 kV Rogova 1	20.05.2014	31.12.2014
3	TS 10/0,4 kV Rogova 7	28.06.2014	31.12.2014
4	TS 10/0,4 kV Rogova 8	03.08.2014	31.12.2014
5	TS 10/0,4 kV Rogovë te xhamija	13.04.2014	28.10.2014
6	TS 10/0,4 kV Rogova te Berisha	20.04.2014	28.10.2014
7	TS 10/0,4 kV Xërxë IV	15.11.2014	28.10.2014
8	TS 10/0,4 kV Xërxë I	21.08.2014	31.12.2014
9	TS 10/0,4 kV Xërxë III	05.09.2014	31.12.2014
10	TS 10/0,4 kV Xërxë VI	20.11.2014	31.12.2014
11	TS 10/0,4 kV Xërxë V	10.10.2014	31.12.2014